

L I G J
Nr.8534, datë 14.10.1999

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES PËR NDRYSHIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN E PUNËVE KOMUNITARE””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja për ndryshimin e “Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e punëve komunitare””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.2459, datë 18.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KREDIA NUMËR 3164-ALB
(AMENDAMENT)

MARRËVESHJA PËR PËRMIRËSIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË PËR ZHVILLIM

- Projekt i Punëve të Komunitetit -

Marrëveshja datë 18/7/1999, midis SHQIPËRISË (Huamarrës) dhe SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (Shoqata).

MEQË (A) Huamarrësi dhe Shoqata kanë hyrë në një Marrëveshje Kredie për Zhvillim (Projekt i Punimeve të Komunitetit), datë 1 shkurt 1999, (Marrëveshja e Kredisë për Zhvillim) për nevojat e dhënies së mbështetjes gjatë zbatimit të projektit të Punimeve të Komunitetit, siç është përshkruar në Relacionin (A) të Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim (Projekti);

(b) Huamarrësi i ka kërkuar Shoqatës të sigurojë asistencë shtesë të mëtejshme në mbështetje të projektit, duke rritur shumën e disponueshme sipas Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim me një shumë në monedha të ndryshme ekuivalent në tre milionë e shtatëqindmijë SDR (3.700,000); dhe

MEQË Shoqata ka rënë dakord bazuar, ndër të tjera, të sigurojë një asistencë shtesë të tillë sipas kushteve dhe termave të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

Prandaj Palët bien dakord si më poshtë :

Neni 1

Amendamentet për Marrëveshjen e Kredisë për Zhvillim

Seksioni 1.01. Seksioni 1.02 të Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim është përmirësuar duke hequr “dhe” në fund të Nënseksionit (f), duke e zëvendësuar “dhe” me “për” në fund të Nënseksionit

(g) dhe duke shtuar një Nënseksion të ri (h) si më poshtë:

“(k) “Marrëveshja e Përmirësuar” nënkupton Marrëveshjen për përmirësimin e Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim (Projekt i Punëve të Komunitetit) midis Huamarrësit dhe Shoqatës në 1 shkurt 1999”.

Seksioni 1.02. Seksioni 2.01 i Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim është rregulluar dhe lexon si më poshtë :

“Seksioni 2.01. Shoqata bie dakord t’i japë Huamarrësit, sipas normave dhe kushteve të përcaktuara ose referuar në Marrëveshjen e Kredisë për Zhvillim, një shumë në monedha të ndryshme ekuivalente me 10 milion e dyqindmijë SDR (10.200 000) (Kredi), e cila përfshin:

(a) shuma fillestare në monedha të ndryshme ekuivalent me gjashtëmilion e pesëqindmijë SDR (SDR 6.500.000) (financimi fillestar); dhe (b) një shumë shtesë në monedha të ndryshme ekuivalent me tre milion e shtatëqindmijë SDR (SDR 3.700.000) (financimi shtesë)”.

Seksioni 1.03. Një klauzolë është shtuar në fund të Seksionit 2.04 (b) (i) të Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim, që lexon si më poshtë:

“me kusht që angazhimet e caktuara në Financimin Shtesë do të rriten 60 ditë mbas datës së kësaj Marrëveshjeje të Përmirësuar:”

Seksioni 1.04. Shtojca 1 e Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim është rishikuar siç dhe është treguar në Annex tek kjo Marrëveshje.

Seksioni 1.05. Një fjali është shtuar në fund të përshkrimit të Pjesës B të Shtojcës 2 të Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim që lexon si më poshtë :

“Përgatitja e shërbimeve për mbështetje sociale dhe të Komunitetit”.

Neni 2

Data efektive; Përfundimi

Seksioni 2.01. Kjo Marrëveshje e Përmirësuar nuk hyn në fuqi derisa Shoqatës t’i jepet evidenca e pëlqyeshme për të që zbatimi dhe shpërndarja e kësaj Marrëveshjeje të Përmirësuar në emër të Huamarrësit është autorizuar në kohën e duhur ose është ratifikuar nga të gjitha mekanizmat e duhura qeveritare.

Seksioni 2.02. Si pjesë e evidencës që duhet të jepet sipas Seksionit 2.01 të kësaj Marrëveshjeje të Përmirësuar, Shoqatës duhet t’i jepet një opinion ose opinione të pëlqyeshme për Shoqatën të juristit të pranueshëm për Shoqatën ku tregohet se në emër të Huamarrësit kjo Marrëveshje e Përmirësuar është autorizuar në kohën e duhur ose ratifikuar nga, zbatuar dhe shpërndarë në emër të, Huamarrësi dhe është ligjërisht i detyruar ndaj huamarrësit në përputhje me kushtet e tij.

Seksioni 2.03. Marrëveshja e përmirësuar hyn në fuqi në datën në të cilën Shoqata do të dërgojë tek huamarrësi njoftimin e pranimit të evidencës së kërkuar nga Seksioni 2.01 të kësaj Marrëveshjeje të Përmirësuar.

Seksioni 2.04. Nëse kjo Marrëveshje e Përmirësuar nuk ka hyrë në fuqi 90 ditë mbas datës së kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje e Përmirësuar dhe të gjitha detyrimet e palëve do të mbyllen derisa Shoqata të caktojë një datë të mëvonshme për qëllimet e këtij Seksioni. Nëse kjo Marrëveshje do të përfundojë sipas dispozitave të këtij seksioni, Marrëveshja e Kredisë për Zhvillim do të vazhdojë në fuqi dhe efekt të plotë sikur kjo Marrëveshje e Përmirësuar të mos ishte zbatuar.

PARA DËSHMITARËVE, palët nënshkruese, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë rënë dakord që kjo Marrëveshje të nënshkruhet me emrat e tyre përkatës në distriktin e Columbia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në datën dhe vitin e lartshënuar për herë të parë.

SHQIPËRIA

Nga Pandeli MAJKO
Përfaqësuesi i Autorizuar

SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

Nga J.D.Wolfensohn
Nënpresidenti Rajonal
Europa dhe Azia Qendrore

ANNEX SHTOJCA 1 TËRHEQJA E FITIMEVE TË KREDISË

1. Tabela e mëposhtme përcakton kategoritë e treguesve që do të financohen nga fitimet e Kredisë, shpërndarjen e shumës së Kredisë për çdo Kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për treguesit që do të financohen në çdo kategori :

Kategoria	Shuma e Kredisë së Alokuar (shprehur në SDR të barasvlefshme	% e shpenzimeve për t'u financiar
(1) Punimet civile sipas pjesës A të Projektit.	6.840.000	90 %
(2) Shërbimet e konsulentëve, Studimet dhe trajnimi sipas Pjesës B dhe C të Projektit.	920.000	100 %
(3) Shërbimet socialteknike sipas Pjesës B të Projektit	700.000	100 %
(4) Mallrat sipas Pjesës C të Projektit	450.000	100 % të shpenzimeve të huaja, 100 % të shpenzimeve lokale (kostoja jashtë 85 % të për
fabrikës) dhe shpenzimeve lokale artikuj të tjerë të prokuruar në vend.		
(5) Kostot operacionale shtesë	620.000	100 %
(6) Të paalokuara	670.000	
TOTALI	10.200.000	

2. Për nevojat e kësaj Shtojce :

(a) termi “shpenzime të huaja” u referohet shpenzimeve në monedhën e çdo vendi tjetër përveç asaj të Huamarrësit për mallrat dhe shërbimet e furnizuara nga territori i çdo vendi tjetër përveç atij të Huamarrësit;

(b) termi “shpenzime lokale” u referohet shpenzimeve në monedhën e Huamarrësit ose për mallrat ose shërbimet e furnizuara nga territori i Huamarrësit; dhe

(c) termi “kostos operacionale e shtuar” kupton shpenzimet operacionale dhe të mirëmbajtjes, të cilat nuk kishin ndodhur pa Projektin dhe në to përfshihen, ndër të tjera, kostot për : (i) mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve të prokuruar ose të përdorura për Projektin; (ii) pagat e personelit të ADF-së, përveç atyre të punonjësve publikë të marrë për nevojat e Projektit; (iii) pajisje konsumi për zyrat.

3. Pa marrë parasysh dispozitat e paragrafit 1 më sipër, asnjë tërheqje nuk mund të bëhet për : (a) pagesa për shpenzime të bëra para datës së kësaj Marrëveshjeje; (b) shpenzimet sipas kategorisë (1) për Pjesën A të Projektit derisa shpenzime të tilla bëhen në përputhje me procedurat, termat dhe konditat e përcaktuara ose referuar në Shtojcën 2 të Marrëveshjes së Projektit dhe (c) Shpenzimet sipas Kategorisë (3) për pjesën B të projektit derisa Shpenzime të tilla bëhen në përputhje me procedurat e pranueshme për Shoqatën.

4. Shoqata mund të kërkojë të bëhen tërheqje nga Llogaria e kredisë në bazë të deklaratave të shpenzimeve për shpenzimet sipas kontratave për : (i) punime që nuk kalojnë shumën \$ 150.000 ekuivalent; (ii) mallra që kushtojnë më pak se \$ 50.000 ekuivalent; (iii) firmat konsultuese që nuk e kalojnë vlerën \$ 100.000 ekuivalent, për konsulentët individualë që nuk e kalojnë vlerën \$ 30.000 ekuivalent; dhe (iv) studime, trajnime dhe kostot operacionale të shtuar sipas termave dhe konditave që Shoqata do të specifikojë me një shënim për huamarrësin.

KREDIA NUMËR 3164-ALB (Amendament)

Marrëveshja për Përmirësimin e Marrëveshjes së Projektit

- Projekti i Punëve të Komunitetit -

Marrëveshja datë 18/7/1999 midis SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR
ZHVILLIM (Shoqata) dhe FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (ADF)

MEQË (A) Shqipëria (Huamarrës) dhe Shoqata kanë hyrë në një Marrëveshje Kredie për Zhvillim (Projekt i Punimeve të Komunitetit), datë 1 shkurt 1999, (Marrëveshja e Kredisë për Zhvillim) për nevojat e dhënies së mbështetjes gjatë zbatimit të Projektit, siç është përshkruar në Shtojcën 2 të Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim;

(b) Huamarrësi i ka kërkuar Shoqatës të sigurojë asistencë shtesë të mëtejshme në mbështetje të projektit, duke rritur shumën e disponueshme sipas Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim me një shumë në monedha të ndryshme ekuivalent në tre milion e shtatqindmijë SDR (3.700.000); dhe

MEQË ADF-ja duke marrë në konsideratë që Shoqata hyri në një marrëveshje që përmirëson Marrëveshjen e Kredisë për Zhvillim me Huamarrësin, ka rënë dakord të ndërmarrë detyrimet e përcaktuara në Marrëveshjen e Projektit, datë 1 shkurt 1999 dhe amendamentet e mëposhtme tek Shtojca I siç janë përcaktuar këtu më poshtë:

1. Shuma në total e kontratave për punimet sipas Procedurave të Tenderit Konkurses Kombëtar u shqyrtua të lexohet \$ 10,527,000;
2. Shuma në total e kontratave sipas Procedurave të Blerjes Ndërkombëtare u shqyrtua të lexohet \$ 450,000;
3. Shuma në total e kontratave sipas Procedurave të Blerjes Kombëtare u shqyrtua të lexohet \$ 250,000;
4. Pjesa B e Seksionit II është rishikuar dhe tani lexohet:

1. “Zgjedhja Bazuar në Kualifikimet e Konsulentëve

Shërbimet e konsulentëve për vlerësimet e premtuesve; trajnim për pushtetet lokale dhe komunitetet për problemet e ambientit, formimin e komiteteve të përdoruesve dhe mirëmbajtjen e nënprodukteve, trajnimin jashtë për teknikat inxhinierike dhe vlerësimin e nevojave dhe kapacitetit, të vlerësuar me një kosto më pak se \$ 344,000 ekuivalent në total, mund të prokurohen sipas kontratave dhënë në përputhje me dispozitat e paragrafit 3.1 dhe 3.7 të udhëzuesve të konsulentëve”.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur Marrëveshja për Përmirësimin e Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim bëhet efektive.

SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

Nga: Përfaqësuesi i Autorizuar

ADF

Nga: Përfaqësuesi i Autorizuar